



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË NPL STACIONIT TË AUTOBUSËVE SH.A. PRISHTINË PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, prill 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë (NPL Stacioni i Autobusëve SH.A. Prishtinë), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin “Baza për Opinion të Kundërt”, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë deri me 31 dhjetor 2025, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

- A1 Ndërmarrja kishte prezantuar pasuri afatgjata në pasqyrat financiare vjetore me vlerë prej 20,514,007€, Megjithatë, janë identifikuar dobësi të rëndësishme në menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive, të cilat ndikojnë në besueshmërinë dhe plotësinë e informacionit financiar.
- C1 Ndërmarrja gjatë vitit 2025 kishte pranuar dy raporte të rivlerësimit për pasuritë e paluajtshme dhe për pasuritë e luajtshme. Megjithatë, për pasuritë e paluajtshme nuk kishte trajtuar eliminimin e zhvlerësimit të akumuluar në vlerë prej 390,620€, ndërsa për pasuritë e luajtshme rivlerësimi nuk është reflektuar në regjistrat kontabël dhe pasqyrat financiare vjetore.
- A2 Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar tek gjithsej ekuiteti vlerën 21,665,491€, mirëpo për vlerën e fitimeve të mbajtura (2,172,383€), dhe saldon fillestare të rezervave tjera në vlerë 14,196,665€, ndërmarrja nuk posedon evidenca analitike mbështetëse për këto saldo të cilat do të mundësonin verifikimin e lëvizjeve të tyre ndër vite.
- B1 Ndërmarrja tek pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse kishte prezantuar të hyrat në vlerë 1,745,583€, duke i mbivlerësuar ato për 289,559€.
- A3 Ndërmarrja në pasqyrën e pozitës financiare pasuritë dhe detyrimet tjera afatshkurtra nuk i kishte prezantuar sipas dokumenteve burimore apo shënimeve kontabël.

- B2 Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera në vlerë neto prej 119,451€.
- Ndërmarrja nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga klientët dhe nuk kishte njohur fare provizionime vjetore për llogaritë e arkëtueshme ndër vite.
- A4 Ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin e llogarive të arkëtueshme me klientët e saj dhe si rrjedhojë ndërmarrja me (2) dy klient nuk kishte bërë harmonizimin periodik dhe ka rezultuar me diferencë prej 10,033€ me shënimet kontabël, në (2) dy raste, ndërmarrja kishte faturuar pa kontratë dhe klientët refuzojnë obligimet e tyre në vlerë prej 42,873€.
- A5 Shënimet kontabël nga të cilat rrjedhin pasqyrat financiare nuk respektojnë parimin e kontabilitetit të dyfishtë, pasi ana kredi tejkalon anën debi për 14,530€, duke reflektuar mungesë të kontrolleve dhe duke cenuar besueshmërinë e të dhënave kontabël dhe pasqyrave financiare të ndërmarrjes.
- A6 Ndërmarrja nuk kishte përpiluar PFV-të në bazë të modelit ilustrues të prezantimit të PFV-ve si dhe nuk kishte prezantuar saktë informacionet krahasues për periudhën paraprake në pasqyrat financiare.
- A7 Ndërmarrja nuk kishte bërë shpalosjen e të dhënave të prezantuara në PFV sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes/ve të përshkruara në kapitullin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A8 Ndërmarrja nuk kishte hartuar dhe azhurnuar rregulloret sipas kërkesave ligjore për afarizmin e ndërmarrjes.
- A9 Raportet e tremujorëve të vitit 2025 nuk i përmbajnë kërkesat ligjore lidhur me përmbajtjen e raporteve tremujore siç e kërkon neni 31.1 i Ligjit të Ndërmarrjeve Publike si dhe raporti vjetor deri në prill të vitit 2026 nuk ishte përpiluar.
- A10 Ndërmarrja nuk kishte përdorur modulën e e-prokurimit për nenaxhimin dhe vlerësimin e performancës së kontratave, duke ndikuar në transparencën dhe efektivitetin e menaxhimit të kontratave.
- A11 Mungon raporti i pranimit si dëshmi për konfirmimin e pranimit dhe funksionalizimit të softuerit sipas kontratës.
- A12 Mospërputhje ndërmjet Listës së Çmimeve të publikuar nga ndërmarrja në sistemin e e-prokurimit dhe Listës së Çmimeve të dorëzuar nga operatori ekonomik gjatë ofertimit, ku kjo e fundit përmbante më shumë pozicione.
- A13 Ndërmarrja nuk kishte hartuar Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm që e mbulon vitin 2025.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të NPL Stacioni i Autobusëve SH.A. Prishtinë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e NPL Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi identifikuar mangësi të rëndësishme dhe fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë fokus të shtuar për shkak të ndikimit material përfshijnë: dobësi në regjistrin e aseteve dhe trajtim jo të duhur të rivlerësimit të pasurive, mosprezantim të drejtë dhe të saktë të pasurive dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra, të hyrave dhe kostos së mallit të shitur, llogarive të arkëtueshme, si dhe prezantim jo të plotë dhe jo të saktë të shënimeve shpjeguese.

Si rezultat i këtyre çështjeve me ndikim material dhe gjithëpërfshirës, pasqyrat financiare vjetore nuk paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të saktë gjendjen financiare, performancën financiare dhe rrjedhat e parasë të ndërmarrjes, në përputhje me standardet përkatëse të raportimit financiar.

Ky raport ka rezultuar me gjithsej 17 rekomandime, prej të cilave 14 janë rekomandime të reja, dhe dy (2) janë rekomandime të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Dobësi në regjistrin e aseteve

Gjetja

SNK 16 pika 6, përcakton se, kosto është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare të paguara ose vlera e drejtë e shumës së dhënë për të blerë një aktiv në momentin e blerjes ose ndërtimit të tij. Po ashtu, SNK16 paragrafi 7 përcakton se kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse: a) është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin te njësia ekonomike; dhe b) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Gjatë auditimit janë identifikuar parregullsitë në regjistrin e asetëve të ndërmarrjes si në vijim:

Janë identifikuar që toka dhe 17 struktura ndërtimore (rrethoja metalike, fontana etj) në regjistrin e pasurive janë të regjistruara me njësi matëse copë një (1) dhe jo sipas sistemit metrik për matje të sipërfaqes;

Në regjistër e asetëve ekzistojnë 77 pasuri (kamera, monitor dhe UPS etj) të cilat kanë vlerë zero (0). Sipas zyrtarëve këto pasuri nuk janë funksionale dhe janë jashtë përdorimit, mirëpo nuk janë marrë veprimet e duhura për trajtimin e tyre;

Në regjistrin e asetëve, nuk janë të regjistruara dy softverët dhe laurat e blera gjatë vitit 2025, vlera totale e së cilave ishte 37,803€;

Në regjistër të asetëve figuron një artikull me përshkrimin "korigjim aseti" me vlerë 4,990€ e cila nuk është pasuri e ndërmarrjes;

Ne kemi identifikuar se regjistri ku janë të regjistruara të gjitha asetet nuk përmban informata të plota, në lidhje me datën e blerjes së pasurisë, më tutje nuk ka të dhëna në lidhje me gjendjen fizike të pasurisë dhe lokacionin e tyre, dhe kjo e bënë të vështirësuar menaxhimin dhe raportimin e tyre.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe se ndërmarrja nuk kishte arritur të rishikojë në tërësi regjistrin e pasurive ndër vite.

Ndikimi

Këto dobësi ndikojnë në paraqitjen jo të drejtë dhe jo të plotë të pasurive në pasqyrat financiare vjetore, duke rezultuar në mbivlerësim apo nënvlerësim të tyre, shtrembërim të regjistrit të asetëve dhe ulje të besueshmërisë së raportimit financiar. Gjithashtu, mungesa e informatave të plota dhe evidencave mbi gjendjen dhe lokacionin e pasurive dobëson kontrollin e brendshëm dhe rrit rrezikun e keqmenaxhimit, humbjes apo keqpërdorimit të pasurive.

Rekomandimi A1

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që të bëhet rishikimi i plotë i regjistrit të pasurive në mënyrë që të identifikojë të gjitha mangësitë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme me qëllim që vlera e pasurive të prezantohet drejtë dhe saktë në pasqyra financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C1 - Trajtim jo i duhur i pasurive të rivlerësuara**Gjetja**

Sipas SNK 16 - Prona, impiante dhe pajisje paragrafi 31 pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të mbartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim.

si dhe paragrafi 35 Kur një zë i klasës toka, ndërtesa, makineri e pajisje rivlerësohet, i gjithë amortizimi i akumuluar vlera neto kontabël e atij aktivi rregullohet sipas vlerës së rivlerësuar. Në datën e rivlerësimit, aktivi trajtohet sipas një nga mënyrave të mëposhtme pika b amortizimi i akumuluar eliminohet tek vlera e mbartur bruto e aktivitet.

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja kishte ndërmarrë veprime për rivlerësimin e aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme. Për pasuritë e paluajtshme, ndërmarrja kishte aplikuar vlerat e rivlerësuara në pasqyrat financiare megjithatë, gjatë trajtimit të tyre nuk kishte kryer kontabilizimin e duhur për eliminimin e zhvlerësimit të akumuluar në vlerë prej 390,620€, duke mbivlerësuar vlerën e aseteve në PFV për këtë diferencë.

Ndërsa për pasuritë e luajtshme, sipas raportit të të rivlerësimit me datën 15.12.2025 që ishte me vlerë 71,419€ zyrtarët nuk kishin ndërmarrë veprime për ta inkorporuar atë në regjistrat kontabël dhe në pasqyrat financiare vjetore pasi që kishin pranuar me vonesë raportin e rivlerësimit.

Mos funksionimi i kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrje jo adekuate gjatë procesit të rivlerësimit ka ndikuar në trajtim jo të duhur të rivlerësimit të pasurive.

Ndikimi

Trajtimi jo i duhur i rivlerësimit çon në paraqitje jo të saktë të vlerës së pasurive dhe rezervave tjera në pasqyrat financiare dhe rrit rrezikun e shtrembërimit material të tyre.

Rekomandimi C1

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që menaxhmenti të zbatojë në mënyrë të plotë dhe korrekte trajtimin kontabël të rivlerësimeve, përfshirë eliminimin e zhvlerësimit të akumuluar dhe regjistrimin e të gjitha ndryshimeve në regjistrat kontabël, në mënyrë që të sigurohet paraqitje e drejtë dhe e besueshme e pasurive në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mungesë e shënimeve analitike për elementet e ekuitetit**Gjetja**

Sipas SNK1 paragrafi 15 Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar (Kuadri konceptual).

Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar tek gjithsej ekuiteti vlerën 21,665,491€, mirëpo për vlerën e fitimeve të mbajtura (2,172,383€) dhe saldon fillestare të rezervave tjera në vlerë 14,196,665€, ndërmarrja nuk posedon evidenca analitike mbështetëse për këto saldo të cilat do të mundësonin verifikimin e lëvizjeve të tyre ndër vite.

Mungesa e këtyre evidencave e bën të pamundur ndërlidhjen e këtyre shumave me regjistrat kontabël dhe transaksionet përkatëse, si dhe nuk siguron gjurmueshmëri të plotë nga ndryshimet e ndodhura në ekuitet deri te pasqyrat financiare. Për më tepër, nuk ka informata të mjaftueshme nëse këto saldo janë rezultat i fitimeve të akumuluar, rivlerësimeve, apo transaksioneve të tjera kapitale.

Kjo ka ndodhur pasi që ndërmarrja nuk ka mbajtur dhe nuk posedon të dhëna analitike për “rezervat e tjera” dhe “fitimet e mbajtura”, si dhe si rezultat i ndryshimit të softuerit të kontabilitetit nuk ekzistojnë shënimet për saldon fillestare.

Ndikimi

Mungesa e të dhënave mbështetëse për vlerat e prezantuara në pasqyrat financiare vjetore rrit rrezikun e shtrembërimit material dhe ul besueshmërinë e pasqyrave financiare, duke vështirësuar verifikimin dhe transparencën e tyre.

Rekomandimi A2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që menaxhmenti të vendosë dhe zbatojë kontrolle efektive për mbajtjen e evidencave analitike të plota dhe të sakta për të gjitha elementet e ekuitetit, përfshirë “rezervat e tjera” dhe “fitimet/humbjet e mbajtura”, në mënyrë që të mundësohet gjurmueshmëri e plotë dhe të sigurohet paraqitje e drejtë dhe e besueshme në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mbivlerësimi i të hyrave dhe kostos së mallit si rezultat i prezantimit bruto të të ardhurave

Gjetja

Sipas standardit ndërkombëtar të raportimit financiar 15 të ardhurat nga kontratat me klientët B 36 njësia ekonomike njih të ardhurat në madhësinë e ndonjë tarife ose komisioni për të cilën pret të ketë të drejtë në këmbim të ndihmës për mallrat apo shërbimet e specifikuar për t'u dhënë nga pala tjetër. Tarifa ose komisioni i një njësie ekonomike mund të jetë shuma neto e shumës korresponduese që njësia ekonomike mban pasi i paguan palës tjetër shumën korresponduese të marrë në këmbim të mallrave apo shërbimeve që do të ofrohen nga ajo palë.

Ndërmarrja tek pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse përkatësisht tek të hyrat kishte prezantuar vlerën 1,745,583€ prej tyre 289,559€, kanë të bëjnë me të hyrat nga biletat e përjashtuara, pasi që këto nuk janë të hyra të ndërmarrjes, këto i përkasin agjensioneve të ndryshme që ndërmarrja shet biletat për ato, ndërmarrja duhet t'i njoh si të hyra vetëm pjesën e komisionit dhe jo totalin e të hyrave që i realizon. Po ashtu, ndërmarrja të njëjtën shumë e kishte njohur edhe në koston e mallrave të shitura për efekt barazimi edhe për kundër faktit që këto nuk ishin shpenzime.

Ndërmarrja kishte ndërmarrë veprime duke i korrigjuar vetëm në dokumente të brendshme mirëpo jo edhe në pasqyrat financiare vjetore.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së analizës dhe zbatimit të duhur të kërkesave të SNRF 15 lidhur me njohjen dhe prezantimin e të ardhurave dhe klasifikimin e saktë të mjeteve të arkëtuara në emër të palëve të tjera.

Ndikimi

Kjo ka ndikuar në mbivlerësim të të hyrave dhe KMSH-së dhe prezantimin jo të drejtë të pasqyrave financiare duke shtrembëruar treguesit financiarë të njësisë, përfshirë nivelin e të hyrave, strukturën e shpenzimeve dhe madhësinë e qarkullimit.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve duhet të rishikojë trajtimin kontabël të të ardhurave në përputhje me kërkesat e SNRF 15, duke siguruar që të ardhurat të njihen vetëm në shumën që i takon ndërmarrjes, ndërsa shumat e arkëtuara në emër të palëve të tjera të paraqiten si detyrime derisa të transferohen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Mos prezantim i drejtë dhe i saktë i pasurive/detyrimeve tjera afatshkurtra

Gjetja

Sipas SNK1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar. Po ashtu, Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim, Financiar dhe Auditim, neni 12.1, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmimeve të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare pasuri tjera afatshkurtra në vlerë prej 143,913€, ndërsa sipas shënimeve kontabël kjo vlerë ishte 388,148€, si dhe detyrime tjera afatshkurtra në vlerë prej 48,865€, ndërsa sipas shënimeve kontabël kjo vlerë ishte 288,083€, pra këtu na paraqiten diferenca mes shënimeve kontabël dhe PFV-ve.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se vlerat e prezantuara lidhen me pasuritë dhe obligimet tatimore, të cilat ishin vendosur manualisht në pasqyrat financiare dhe nuk ishin gjeneruar nga shënimet kontabël. Si rezultat i këtyre mospërputhjeve, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri të mjaftueshme dhe të përshtatshme për saktësinë e vlerave të prezantuara në pasqyrat financiare.

Kjo kishte ndodhur pasi që vlerat e prezantuara në pasqyrat nuk ishin gjeneruar nga sistemi i kontabilitetit por ishin vendosur manualisht.

Ndikimi

Këto mospërputhje dhe regjistrimi manual i vlerave në pasqyrat financiare ndikojnë në besueshmërinë dhe saktësinë e informacionit financiar të prezantuar, si dhe rrisin rrezikun që pasuritë dhe detyrimet të mos prezantohen drejtë dhe në përputhje me standardet e raportimit financiar.

Rekomandimi A3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që pasuritë dhe detyrimet tatimore të cilat prezantohen në pasqyrat financiare vjetore duhet të bazohen nga dokumentet burimore (shënimet kontabël) dhe të paraqesin saktë dhe drejtë gjendjen e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme tregtare

Gjetja

Bazuar në SNRF 9 Instrumentet Financiare paragrafi 5.5.1 dhe 5.5.2 nga ndërmarrja kërkohet të njohë një provizion për humbje për përkeqësim të pritshëm të kredisë të një aktivi financiarë, për të cilat duhet të plotësohen kushtet e dëmtimit. Ndërmarrja duhet të zbatojë kërkesat e dëmtimit për njohjen dhe matjen e shumës së humbjes për aktivet financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse. Si dhe paragrafi 5.5.3 kërkohet që në çdo datë raportimi, një njësi ekonomike të masë provizionin për humbjen e një instrumenti financiar në atë shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së tij nëse rreziku i kreditit të atij instrumenti financiar është shtuar ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare.

Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera në vlerë prej 119,451€. Ndërmarrja nuk kishte bërë provizionimin e llogarive të arkëtueshme tregtare në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF9)- Instrumentet financiare. Prandaj, mungesa e aplikimit të lejimeve/provizionimeve ndër vite ndikon që vlera bartëse neto e llogarive të arkëtueshme tregtare në PVF të mos jetë e saktë.

Ndërmarrja ishte në proces të finalizimit të rregullorës për provizionimin e llogarive të arkëtueshme.

Mos aplikimi i provizionimit të llogarive të arkëtueshme ka ndodhur për shkak të mungesës së procedurave të brendshme dhe udhëzimeve të qarta për identifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve potenciale nga klientët për ndërmarrjen si dhe mungesës së marrjes së veprimeve në përputhje me kërkesat e standardeve dhe rëndësinë e raportimit të drejtë të llogarive të arkëtueshme.

- Ndikimi** Mos vlerësimi i llogarive të arkëtueshme tregtare përveç që është në kundërshtim me kërkesat e standardeve të kontabilitetit për matjen e aktivitetit financiar dhe rregulloren e brendshme ka ndikim material në vlerën neto të llogarive të arkëtueshme që prezantohen në pasqyrat financiare vjetore.
- Rekomandimi B2** Bordi i Drejtorëve duhet të përpilojë dhe zbatojë një politikë të qartë për provizionimin e llogarive të arkëtueshme në përputhje me kërkesat e SNRF9, si dhe të bëhet analizë gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga klientët.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mungesë e dokumenteve burimore dhe mos harmonizim periodik me klientët

- Gjetja** Sipas SNK1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar. Po ashtu, Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim, Financiar dhe Auditim, neni 12.1, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Gjatë shqyrtimit të mostrave të llogarive të arkëtueshme janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Në (2) dy konfirmime të pranuar kemi diferencë prej 7,209€ me shënimet kontabël për të cilat ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizim periodik;
- Në (2) dy raste, ndërmarrja kishte faturuar pa kontratë dhe klientët refuzojnë obligimet e tyre në vlerë prej 42,873€.
- Po ashtu ndërmarrja posedon, një listë me klientë në vlerë 43,044€, të cilët nuk kanë qenë aktiv nga viti 2024, për të cilët nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura për inkasim të borxheve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të dobësive në kontrollin e brendshëm dhe procedurave të pamjaftueshme për monitorimin, dokumentimin dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Dobësitë e tilla kanë ndikuar në pasaktësi të raportimit financiar, mbivlerësimin e të hyrave për faturimet pa kontratë, si dhe në mosarkëtimin e borxheve të vjetra, duke rritur rrezikun për humbje të të ardhurave dhe vështirësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi A4

Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të merren veprimet e nevojshme në lidhje me trajtimin e llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar, përfshirë monitorimin e konfirmimeve, ndjekjen e borxheve të vjetra, verifikimin e kontratave para faturimit dhe trajtimin e llogarive me vlera negative, me qëllim reduktimin e rrezikut për pasaktësi në raportimin financiar, humbje të të ardhurave dhe vështirësisë në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Mos barazimi i debisë dhe i kredisë në shënimet kontabël

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet Raportim Financiar dhe Auditim Neni 11 regjistrat kontabël dhe librat e llogarive pika 2 regjistrat kontabël përfshijnë regjistra të hyrjeve fillestare kontabël dhe regjistra mbështetës, siç janë kontrollet dhe regjistrat e transfereve të fondeve elektronike; fatura, kontratave, librave kryesor dhe ato dytësor, shënimeve në ditar dhe rregullimeve tjera në pasqyrat financiare të cilat nuk janë reflektuar tek hyrjet në ditar, dhe regjistrat si fletë pune që mbështesin alokimet e kostos, llogaritjet, barazimet dhe shpalosjet. Regjistrat kontabël ruhen në sistemin e regjistrimit të dyfishtë kontabël

Gjatë auditimit kemi identifikuar se shënimet kontabël (libri dhe ditari kryesor), të cilat shërbejnë si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare, nuk janë të balancuara, pasi ana e kredi tejkalon anën e debi me një vlerë prej 14,530€.

Kjo ka ndodhur nga mungesa e mirëfilltë e kontrolleve në departamentin përkatës që është përgjegjës për përpilimin e pasqyrave financiare vjetore, dhe mangësive sistematike në procesin e regjistrimit të të dhënave financiare.

Ndikimi Mos barazimi i librit kryesor dhe ditarit ndikon në mos besueshmërinë e të dhënave kontabël prej të cilave rrjedh përpilimi i PFV-ve të ndërmarrjes.

Rekomandimi A5 Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që ndërmarrja gjatë regjistrimit dhe përpilimit të PFV-ve ka përdorur kontabilitetin e dyfishtë si dhe duhet të bëhen korrigjimet e nevojshme dhe identifikimi i gabimeve që ka shkaktuar këtë mos barazim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A6 - Ndërmarrja nuk e kishte prezantuar saktë periudhën krahasuese

Gjetja Sipas SNK 1, Informacionet krahasuese pika 38 për të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare duhet të paraqesë informacion krahasues në lidhje me periudhën e shkuar për të gjitha shumat e raportuara në paqyrat financiare të periudhës aktuale si dhe Udhëzimi Administrativ MF-Nr. 07/2019 për strukturën, përmbajtjen dhe dorëzimin e raportimeve financiare vjetore neni 10 shtojcat modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare individuale në pajtueshmëri me SNRF/SNK.

Ndërmarrja nuk kishte prezantuar saktë informacionet krahasues për periudhën paraprake të vitit 2024 në pasqyrat financiare për vitin 2025 për zërat: llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera, detyrimet tjera afat shkurtra, shpenzimet e tatimit në fitim dhe rrjedhimisht edhe fitimin e vitit. Përkatësisht, shumat e raportuara për periudhën aktuale nuk janë shoqëruar me të dhëna krahasuese të sakta dhe/ose të plota për periudhën paraprake.

Për më tepër ndërmarrja nuk i kishte përgatitur PFV-të sipas modelit ilustrues të prezantimit të PFV-ve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të mjaftueshëm gjatë përgatitjes dhe rishikimit të pasqyrave financiare dhe moszbatimi i plotë i kërkesave të standardeve të raportimit financiar dhe rregulloreve të aplikueshme.

Ndikimi Mos prezantimi i saktë i periudhës krahasuese dhe mos përpilimi i PFV-ve në bazë të modelit ilustrues mund të ndikojë në uljen e besueshmërisë dhe krahasueshmërisë së informacionit financiar, duke kufizuar aftësinë e përdoruesve të pasqyrave financiare për të analizuar performancën dhe pozicionin financiar të ndërmarrjes ndërmjet periudhave.

Rekomandimi A6 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që pasqyrat financiare të përgatiten në përputhje me kërkesat e SNK 1 dhe Rregullores së aplikueshme duke përdorur modelin ilustrues të prezantimit të pasqyrave financiare vjetore si dhe prezantim të informacioneve të plota dhe të sakta krahasues për periudhën paraprake për të gjitha zërat e raportuar në pasqyrat financiare

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A7 - Prezantim jo i plotë dhe i saktë i shënimeve shpjeguese**Gjetja**

Sipas SNK1 paragrafi 113, një njësi ekonomike duhet të paraqesë shënimet shpjeguese në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Kur përcakton një mënyrë organizimi, njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë efektin në kuptueshmërinë dhe krahasueshmërinë e pasqyrave të saj financiare. Çdo zë në pasqyrat e pozicionit financiar dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, në pasqyrën e të ardhurave individuale (nëse paraqitet), dhe në pasqyrën e ndryshimeve në kapital neto dhe në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.

Ndërmarrja kishte përpiluar shënimet shpjeguese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, megjithatë të shënimet shpjeguese janë identifikuar dobësitë në vijim:

- Shpalosjet për të gjitha PFV-të nuk paraqesin në mënyrë të mjaftueshme detajet mbi përbërjen e zërave përkatës, si dhe mungojnë sqarimet narrative lidhur me këta zëra;
- Referencat e vendosura për shpenzimet e amortizimit në PFV nuk janë në përputhje me shpalosjet përkatëse;
- Nuk janë ofruar informacione shpjeguese lidhur me ekuitetin;
- Politikat kontabël për pronat, pajisjet dhe impiantet nuk janë të paraqitura në mënyrë të saktë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët e ndërmarrjes i kishin konsideruar si të mjaftueshme informacionet e prezantuara në shënimet shpjeguese.

Ndikimi

Informacionet e shpalosura në shënimet shpjeguese, ndikojnë në cilësinë e pasqyrave financiare duke shkaktuar paqartësi në kuptueshmërinë e informatave, si dhe ndikon që informacionet financiare të mos jenë të plota për përdoruesit e pasqyrave financiare.

Rekomandimi A7

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A8 - Mungesa e rregulloreve dhe mos azhurnimi i tyre për funksionimin e ndërmarrjes

Gjetja

Ligji Nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat si dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike Neni 34.1 të gjitha NP do t'i përgatisin dhe vënë në fuqi rregulloret të cilat kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Po ashtu, neni 8 të statutit për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i autobusëve" SH.A. pika 8.4 përcakton se shoqëria duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë, sipas Ligjeve të Republikës së Kosovës.

Ndërmarrja nuk kishte hartuar dhe azhurnuar rregulloret sipas kërkesave ligjore.

- Mos hartimi i rregulloreve apo udhëzuesit për provizionimin e llogarive të arkëtueshme;
- Mos azhurnimi i rregulloreve për menaxhimin dhe organizimin e punëve dhe detyrave në kontabilitet dhe financa;
- Mos azhurnimi i rregulloreve për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mjeteve themelore aseteve të NPL-së.

Mos hartimi dhe azhurnimi i rregulloreve ka ndodhur për shkak të mungesës së një procedure të përcaktuar për rishikimin dhe përditësimin periodik të akteve të brendshme në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndikimi

Mungesa e rregulloreve dhe mos azhurnimi i tyre mund të ndikoj që trajtimi i çështjeve për rastet e natyrës së njëjtë të jetë i ndryshëm. Kjo reflekton në aktivitetet operacionale dhe financiare të ndërmarrjes.

Rekomandimi A8

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë hartimin, azhurnimin dhe miratimin e rregulloreve të cilat janë të nevojshme për afarizmin e ndërmarrjes duke siguruar aplikimin e tyre në të gjithë ndërmarrjen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Raportet periodike jo në përputhje me Ligjin e NP-ve,**Gjetja**

Ligji Nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe Ministrat si dhe Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publik Neni 31 raportet vjetore dhe tremujore pika 31.1 përcakton se brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin dhe dorëzojnë në Bordin e Drejtorëve një raport për tremujorin e sapo përfunduar i cili përmban si vijon: a) një pasqyrë të strukturuar organizative të NP, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës; b) një shqyrtim të performancës afariste dhe financiare gjatë tremujorit përkatës; c) një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë NP-në; d) një përshkrim të procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të cila NP pritet t'i iniciojë gjatë tremujorit aktual; e) transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse; dhe f) sugjerime dhe propozime për ndryshime të cila me arsye pritet që ta rrisin performancën e NP-së.

Raportet e tremujorëve të vitit 2025 të NP-së përmbajnë vetëm një shqyrtim të performancës financiare dhe afariste të tremujorit përkatës, kështu duke përmbushur vetëm një nga gjashtë kërkesat ligjore lidhur me përmbajtjen e raporteve tremujore siç e kërkon neni 31.1 i Ligjit të Ndërmarrjeve Publike. Më tutje duhet të theksojmë se pesë (5) kërkesat tjera të Ligjit nuk ishin përmbushure nga zyrtarët përgjegjës,

Po ashtu, raporti vjetor për vitin 2025 i cili do të duhej të pëpilohej deri më 14 shkurt 2026 (45 ditë pas përfundimit të vitit kalendarik), deri në prill të vitit 2026 nuk ishte përpiluar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës në punë nga ana e personave përgjegjës për përpilimin e raporteve tre mujore dhe vjetore.

Ndikimi

Mos përpilimi i raporteve tre mujore dhe vjetore me të gjitha kërkesat sipas Ligjit të NP-së ndikon në mos informim të drejtë të Bordit të Drejtorëve dhe të palëve të interesit për aktivitetet dhe objektivat që janë përcaktuar nga ana e menaxhmentit.

Rekomandimi A9

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që raporti vjetore dhe raportet tre mujore të i përmbajnë të gjitha elementet dhe kërkesat që dalin nga Ligjit për NP-të.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A10 - Mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për modulën e kontrata****Gjetja**

Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 f thekson se menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të prokurimit kemi identifikuar se në pesë (5) kontrata të prokurimit publik, ndërmarrja nuk kishte bërë menaxhimin e implementimit të kontratave përmes modulit për menaxhimin e kontratave në platformën elektronike e-prokurimi si dhe në tri (3) raste vlerësimin e performancës së kontraktuesëve pas përfundimit të implementimit të kontratës përmes modulit për vlerësimin e performancës së kontraktuesëve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

Ndikimi Mosrealizimi i menaxhimit dhe vlerësimit të performancës së kontraktuesve në sistemin elektronik dobëson kontrollin dhe monitorimin e zbatimit të kontratave publike, si dhe mund të ndikojë në mungesë të informacionit të besueshëm për performancën e operatorëve ekonomikë për kontratat e ardhshme.

Rekomandimi A10 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulën përkatës në sistemin e prokurimit publik, si dhe të bëjnë vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomikë përmes moduleve përkatëse në sistemin elektronik të prokurimit, në përputhje me manualët përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Furnizim me softver dhe laura pa raport pranimi

Gjetja Rregullorja Nr. 002/2024 për prokurim publik, neni 72A.1, Pranimi i furnizimeve bëhet nga Komisioni për Pranimin e furnizimeve i cili emërohet me Vendim nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Komisioni për Pranimin e furnizimeve ka përgjegjësinë të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së furnizimeve të pranuar, të cilat dokumentohen me procesverbal se janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhërblenjen.

Te kontrata Mirëmbajtja dhe furnizim me softver të shtijes dhe laura në vlerë prej 33,555€, për një periudhë prej 36 muajsh. Ne kemi identifikuar se nuk është hartuar raport pranimi për furnizimin me softuer, si dëshmi që konfirmon pranimin dhe funksionalizimin e tij në përputhje me kushtet e kontratës. Për më tepër si rezultat i kësaj pagesa vazhdon të bëhet çdo muaj në përshkrimin e faturave evidentohet vetëm pagesë 1/36 e kontratës, por softveri nuk figuron as në raport pranimi e as në faturim. Dëshmia e vetme se është blerë sistemi është vetëm kontrata dhe jo dokumente tjera relevante.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontroleve të brendshme dhe mosrespektimit të procedurave nga menaxheri i kontratës lidhur me pranimin dhe dokumentimin e furnizimeve, si dhe mungesës së kontrollit efektiv nga menaxhmenti lidhur me strukturimin e pagesave dhe verifikimin e faturave.

Ndikimi Mungesa e raportit të pranimit rrit rrezikun që pagesat të kryhen pa verifikim të plotë të pranimit të softuerit si dhe mund të ndikojë në pranimin e një produkti që nuk i plotëson specifikimet e kontratës.

Rekomandimi A11 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të gjitha blerjet e mallrave dhe shërbimeve të realizohen në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi. Për këtë qëllim, duhet të përpilohen raporte pranimi për të garantuar se mallrat dhe shërbimet e pranuar janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë. Gjithashtu, të sigurohet që faturat të jenë të qarta, të detajuara dhe të dokumentuara në mënyrë adekuate, për të vërtetuar shpenzimin apo furnizimin për të cilin bëhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A12 - Mospërputhje midis Listës së Çmimeve dhe ofertës financiare të operatorit ekonomik

Gjetja Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024, neni 17.7. Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertë e tij financiare. Pjesa C përbëhet nga Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve.

Te kontrata “Mirëmbajtje tri vjeçare dhe furnizim me softver të shitjes dhe laurave në vlerë 33,555€ për 36 muaj.” Kemi vërejtur se në dosjen e tenderit tek pjesa II përshkrimi i çmimeve autoriteti kontraktues në sistemin e e-prokurimit kishte publikuar Listën e Çmimeve me një (1) pozicion si “Mirëmbajtje tri vjeçare dhe furnizim me sistem të shitjes dhe laurave” mirëpo, gjatë dorëzimit të ofertës financiare, operatori ekonomik fitues ka ndërhy tek pjesa II përshkrimi i çmimeve duke shtuar në katër (4) pozicionet. Ky ndryshim përbën devijim nga dokumenti standard i tenderit dhe ndikon në krahasueshmërinë e ofertave, transparencën e procesit dhe integritetin e procedurës së vlerësimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së verifikimit të përputhshmërisë së Listës së Çmimeve me dokumentin e publikuar në fazën e tenderimit, si dhe kontrollet e pamjaftueshme gjatë pranimit dhe validimit të ofertës financiare.

Ndikimi Kjo mospërputhje mund të cenojë transparencën dhe integritetin e procedurës së prokurimit, si dhe të ndikojë në saktësinë e vlerësimit financiar, duke rrezikuar përputhshmërinë e ofertës me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Rekomandimi A12 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që Lista e Çmimeve të hartohet në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të mos lejojë ndryshime në strukturën e saj gjatë fazës së ofertimit, me qëllim të garantimit të krahasueshmërisë së ofertave, transparencës së procesit dhe integritetit të procedurës së vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A13 - Mos hartimi i Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm

Gjetja Ligji Nr. 067/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 25 Obligimet e drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorëve të brendshëm pika 3.3 përgatitjen dhe dorëzimin e planit strategjik dhe planit vjetor për rishikim dhe miratim tek udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe te Komiteti i Auditimit, në ato subjekte ku është i themeluar ky komitet.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka hartuar Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm i cili e mbulon periudhën 2025. Megjithëse Njësia kishte hartuar një plan vjetor të auditimit të brendshëm, i cili ishte aprovuar në shtator të vitit 2025, mungesa e planit strategjik ka bërë që aktiviteti i auditimit të brendshëm të mos ketë një qasje të strukturuar dhe afatmesme për identifikimin e fushave me rrezik më të lartë që duhet të auditohen. Duhet të theksojmë se planin strategjik është hartuar me datën 16.01.2026, për vitin 2026-2028.

Mos hartimi i Planit Strategjik të auditimit të brendshëm ka ndodhur si rezultat i faktit se zyrtarja e auditimit të brendshëm është angazhuar në ndërmarrje gjatë pjesës së dytë të vitit, gjë që ka kufizuar kohën e nevojshme për përgatitjen dhe miratimin e planit strategjik të auditimit për periudhën përkatëse.

Ndikimi Mos përpilimi dhe aprovimi i Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm ndikon që aktiviteti i auditimit të brendshëm të mos jetë i planifikuar në mënyrë afatmesme dhe të mos bazohet në një qasje të strukturuar të vlerësimit të rrezikut. Si rezultat, ekziston rreziku që fushat me rrezik më të lartë në ndërmarrje të mos identifikohen dhe trajtohen me prioritet në procesin e auditimit.

Rekomandimi A13 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm të hartojë dhe miratojë Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm, i cili do të bazohet në vlerësimin e rreziqeve dhe do të shërbejë si bazë për planifikimin e aktiviteteve të auditimit në ndërmarrje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Sistemet Informative

Çështja A14 - Mungesa e integritit ndërmjet sistemeve dhe përpunimi manual i të dhënave

Gjetja

Bazuar në kontratën e lidhur në mes të NPL Stacioni i Autobusëve dhe operatorit ekonomik për shërbim tre vjeçar për softuer për menaxhim të kontabilitetit financiar neni 1 përcakton se softueri duhet të ofroj: menaxhimin e shitjeve dhe blerjeve me ose pa TVSH, në monedha të ndryshme të artijujve (inventar/shërbim) si dhe kthimet e shitjeve/blerjeve. Këtu përfshihen lidhjet e arkave(sporteleve). Po ashtu, bazuar në Manulin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në mënyrë të kontrolluar dhe të besueshme, duke siguruar që ato të përputhen me rregullat e biznesit, parametrat e konfigurimit dhe skenarët e parashikuar të përpunimit.

Nga evidentimet e kryera me zyrtarët e ndërmarrjes është konstatuar se sistemi i shitjes dhe i laurave nga i cili gjenerohen të hyrat (për biletat e përjashtuara, shërbimi i biletave, parkingu, peronizimi dhe garderoba) nuk është i ndërlidhur në mënyrë automatike me softverin për menaxhimin e kontabilitetit financiar. Si rezultat, të dhënat nga sistemi i shitjes transferohen dhe regjistrohen manualisht në sistemin e kontabilitetit pas verifikimit të Z-raporteve dhe dokumentacionit përcjellës.

Në planin e biznesit për vitin 2026 kishte planifikuar zhvillimin e një sistemi për inkuorporimit e tyre.

Mungesa e ndërlidhjes ndërmjet sistemit të shitjes së biletave dhe softuerit për menaxhimin e kontabilitetit financiar ka ardhur si rezultat i mungesës së planifikimit të koordinuar dhe të integruar nga njësi kërkuese. Sistemet janë iniciuar nga departamente të ndryshme dhe në periudha të ndryshme kohore, pa parashikuar kërkesa për ndërlidhje apo shkëmbim automatik të të dhënave në specifikimet teknike dhe kontratat përkatëse, duke bërë që ato të funksionojnë si sisteme të pavarura.

Ndikimi

Mungesa e ndërlidhjes automatike midis sistemit të shitjes dhe të laurave, si dhe softverit për menaxhimin e kontabilitetit financiar, rrit rrezikun për mospërputhje si pasojë e futjes manuale të të dhënave, ngadalëson procesin dhe raportimin për shkak të verifikimeve dhe regjistrimeve manuale nga zyrtarët, si dhe shton rrezikun për pasaktësi në raportimin financiar. Për më tepër, kjo situatë ndikon negativisht në transparencën dhe gjurmueshmërinë e transaksioneve financiare ditore, duke çuar në pasaktësi dhe mungesë të plotë të gjurmueshmërisë, e cila në tërësi ndikon në uljen e efikasitetit dhe dobësimin e kontrollit financiar të ndërmarrjes.

Rekomandimi A14 Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmarrë hapa për integrimin e sistemit të shitjes dhe të lurrave, si dhe të softverit për menaxhimin e kontabilitetit financiar, me qëllim të automatizimit të ndërlidhjes së të dhënave dhe eliminimit të ndërhyrjeve manuale në proces. Rekomandohet që të dhënat në të dy sistemet të ndërlidhen mes vete, duke vendosur mekanizma kontrolli automatik për verifikimin dhe harmonizimin e tyre. Zbatimi i këtyre masave do të kontribuojë në përmirësimin e saktësisë së raportimit financiar dhe forcimin e kontrollit të brendshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A. ishte kryer nga një kompani private e auditimit e cila kishte dhënë opinion të kualifikuar për PFV e vitit 2024.

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të NPL Stacioni i Autobusëve SH.A. ka rezultuar në 6 rekomandime kryesore. Ndërmarrja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tri (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim pjesërisht i zbatuar dhe dy (2) rekomandime nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.		Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që menaxhmenti të zbatojë në mënyrë të plotë dhe korrekte trajtimin kontabël të rivlerësimeve, përfshirë eliminimin e zhvlerësimit të akumuluar dhe regjistrimin e të gjitha ndryshimeve në regjistrat kontabël, në mënyrë që të sigurohet paraqitje e drejtë dhe e besueshme e pasurive në pasqyrat financiare vjetore.	Ndërmarrja kishte marrë veprime duke bërë rivlerësimin e pasurive mirëpo nuk kishte arritur ta prezantojë dhe ta kontabilizojë saktë në shënimet kontabël dhe në PFV.	Pjesërisht i zbatuar

2.		Bordi i Drejtorëve duhet të rishikojë trajtimin kontabël të të ardhurave në përputhje me kërkesat e SNRF 15, duke siguruar që të ardhurat të njihen vetëm në shumën që i takon ndërmarrjes, ndërsa shumat e arkëtuara në emër të palëve të tjera të paraqiten si detyrime derisa të transferohen.	Ndërmarrja nuk ka marrë hapa konkret për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimi
3.		Bordi i Drejtorëve duhet të përpilojë dhe zbatojë një politikë të qartë për provizionimin e llogarive të arkëtueshme në përputhje me kërkesat e SNRF9, si dhe të bëhet analizë gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga klientët.	Përkundër rekomandimit të dhënë në vitin e kaluar, ndërmarrja nuk kishte ndërmarr veprime për provizionimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
4.		Ndërmarrja duhet të forcojë procesin e dokumentimit dhe pajtimit të detyrimeve ndaj furnitorëve përmes evidencave mbështetëse të brendshme dhe komunikimeve të rregullta me palët e treta, si dhe të kërkojë dhe ruajë konfirmime nga furnitorët të paktën një herë në vit për qëllime të raportimit financiar dhe auditimit. Në rastet kur konfirmimet nuk mund të merren, duhet të sigurohen prova alternative të mjaftueshme dhe të besueshme, si fatura, kontrata, njoftime krediti ose debiti dhe regjistra kontabël. Po ashtu, menaxhmenti duhet të hartojë një politikë të brendshme për verifikimin dhe pajtimin periodik të llogarive të pagueshme, me qëllim rritjen e saktësisë dhe transparencës në pasqyrat financiare.	Ndërmarrja kishte arritur ta implementojë këtë rekomandim.	I zbatuar
5.		Stacioni i Autobusëve duhet të klasifikojë dhe shpalosë të gjitha shpenzimet në pasqyrat financiare sipas natyrës së tyre (si paga, energji, qira, mirëmbajtje, shërbime të jashtme etj) ose sipas funksionit, në përputhje me SNK 1.	Ndërmarrja kishte arritur ta implementojë rekomandimin.	I zbatuar

6.		<p>Stacioni i Autobusëve duhet të ndërmarrë menjëherë hapat për emërimin e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, duke siguruar që kjo pozitë të jetë funksionale, e pavarur dhe e pajisur me burime të mjaftueshme për kryerjen e auditimeve efektive. Po ashtu, duhet të hartohet një plan vjetor i auditimit të brendshëm që adreson rreziqet kyçe dhe fushat me ndikim të lartë në performancën financiare dhe operacionale të ndërmarrjes. Auditimi i brendshëm rekomandohet të raportojë drejtpërdrejt te Bordi i Drejtorëve ose Komiteti i Auditimit, me qëllim ruajtjen e pavarësisë dhe objektivitetit të funksionit.</p>	<p>Ndërmarrja kishte arritur ta implementoj rekomandimin.</p>	<p>I zbatuar</p>
----	--	--	---	------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Liridona Berisha Kelmendi, Udhëheqëse e ekipit



Egzona Maqedonci, Anëtare e ekipit



Valmira Jonuzi, Anëtare e ekipit




Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Dobësi në regjistrin e asetëve	<p>Ne raportin e rivlersimit të derguar të ZKA si dhe në shenimet tona të brendshme toka dhe 17 struktura ndërtimore (rrethoja metalike, fontana etj) në regjistrin e pasurive janë të regjistruara me njësi matëse përkatëse ndërsa në programin e kontabilitetit janë me njësi copë një (1) dhe jo sipas sistemit metrik për matje të sipërfaqes; problem i programit të kontabilitetit, duhet të adresohet tani në Programin e kontabilitetit dhe të zgjidhet kjo çështje por në I kemi shenimet të cilat edhe ia kemi prezentuar ku asetet janë të evidentuara me njësit matëse përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, në regjistrin e asetëve ekzistojnë 77 pasuri (kamera, monitorë, UPS, etj.) të cilat kanë vlerë zero (0). Këto pasuri nuk janë funksionale dhe janë jashtë përdorimit, mirëpo nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për trajtimin e tyre, pasi ka qenë e nevojshme kohë shtesë për rishikimin e rregulloreve për menaxhimin e pasurisë jo-financiare dhe mjeteve themelore.</p> <p>Në regjistrin e asetëve nuk janë të regjistruara dy softuerë dhe licencat përkatëse të blera gjatë vitit 2025, me vlerë totale prej 37,803 €. Duke pasur parasysh se këta softuerë nuk kanë faturë blerjeje në kuptimin e pronësisë, si dhe në fund të periudhës nuk mbeten pronë e institucionit (nuk posedojmë kodin burimor), dhe bazuar në kontratat ekzistuese paguhet vetëm mirëmbajtje mujore apo vjetore, dhe në një situatë ku në rast të ndërprerjes së kontratës nuk kemi më qasje në këta softuerë, është vlerësuar se nuk ekziston e drejta për t'i njohur dhe regjistruar si asetë.</p>	<p>E gjetura qëndron. Ndërmarrja është pajtuar me gjetjen. Megjithatë, komenti I dhënë përmban vetëm sqarime të cilat janë të inkorporuara në kuadër të çështjes. Raporti i vlerësimit nuk është regjistër i pasurisë ku mbahen të gjitha asetet e ndërmarrjes përfshirë blerjet e vitit ku nga prezantohen e pasuritë në pasqyrat financiare vjetore.</p>

	<p>Sipas te dhenave qe i kemi, aset i korigjim eshte i regjistruar me 31.12.2021 sipas listes te derguar nga ndermarrja per regjistrim ne programin e ri (Prill 2022), ndersa serveri SAP100926 eshte i regjistruar me date 18.01.2022. Ps Lista e asetëve kur eshte derguar tek programi Bilanc ka qene i perfshire aset i server ne excel e po i njejt i eshte regjistruar edhe ne kontabilitet, te cilin nuk kemi mund ta rishikojme per ta hjekur nga programi pa nje analize burimore te dokumenteve!.</p>	
Trajtim jo i duhur i pasurive të rivlerësuar	<p>Për shkak të problemeve me programin e kontabilitetit dhe mosfunksionimit të tij në mënyre të kënaqshme, të dhënat janë përpiluar në Excel. Vlera e asetëve në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) është paraqitur sipas excel te cilin edhe e kemi deru ne ZKA, ndersa ZKA po e trajton permes Librit Kryesor nga programit te kontabilitetit i cili po ka probleme ku tani mbetet te ndermirren veprime per te adresuar problemin te programi i kontabilitetit dhe me zgjidhe problemin.</p> <p>Ndersa per raporti i rivlersimit te asetëve e lujteshme eshte nxjerre vone rapororti dhe ka qene e pa mundur te behen rregullimet e nevojshme per tu paraqit ne pasqyra!</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Ndërmarrja ka dhënë arsytetime të cilat janë trajtuar edhe nga jonë në kuadër të çështjes.</p> <p>Auditimi i kategorisë është bërë duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit SNK 16. Ndërmarrja nuk kishte aplikuar në plotni kërkesat që dalin nga standardi lidhur me zhvlerësimin e akumuluar dhe për këtë arsye janë evidentuar diferencat.</p>
Mbivlerësimi i të hyrave dhe kostos së mallit si rezultat i prezantimit bruto të të ardhurave	<p>Ketu ka qene e pa mundur te rregullohet per nje periudhe kaq te shkurt per krejt periudhen e vitit jane marre veprimet dhe kjo per vitin 2026 tani eshte çështje e rregulluar. E deshmuar edhe me dokumentet te cilat i kemi dergu te ZKA</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Ndërmarrja është pajtuar me gjetjen, ka dhënë një sqarim lidhur me veprimet që planifikon të ndërmarrë për vitin e ardhshëm.</p>
Mos prezantim i drejtë dhe i saktë i pasurive/detyrimeve tjera afatshkurtra	<p>Per shkak te problemeve ne programin e kontabilitetit problemeve me saldot e trashegura nga PFV 2024 dhe mosperputhjes se tyre me gjendjen e ATK I kemi vendosur ne menyre manuale shenimet e gjeneruara per obligimet dhe pasurite tatimore nga Sisitemi i ATK dhe jo nga softveri i kontabilitetit.</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Ndërmarrja vetëm e ka pohuar gjetjen dhe ka dhënë arsytetime lidhur me çështjen e prezantuar.</p>

<p>Mungesë e dokumenteve burimore dhe mos harmonizim periodik me klientët</p>	<p>Pika 1:Kjo gjetje lidhet me klientët Liridon Abazi B.I. dhe Dushi SHPK, ku në shënimet tona kontabël figurojnë me një vlerë më të lartë prej 7,209 euro. Ne i kemi dorëzuar ZKA-së evidencat përkatëse të kontabilitetit (kartelat financiare të klientëve në fjalë si dhe marrëveshjet përkatëse). Megjithatë, problemi qëndron në faktin se klientët e lartcekur kanë raportuar vlera të ndryshme në krahasim me gjendjen tonë fillestare. Pika 2:Kjo çështje lidhet me klientët MTI dhe Deva SHPK. Në rastin e MTI-së, faturimi është bërë vetëm mbi bazën e njoftimit për ndryshim çmimi, pa kontratë të re. Ndërsa për Deva SHPK, ne kemi bërë barazimin e kartelës, kemi ndërprerë kontratën dhe kemi iniciuar procedurat për përmbarim.</p> <p style="text-align: right;">Pika 3:</p> <p>Borxhe të trashëguara. Ne kemi filluar kontaktimin e tyre për inkasim dhe deri më tani kemi arritur të mbledhim rreth 1,000 euro. Pas miratimit të rregullores për provizionim, do të vazhdojmë përpjekjet për inkasim. Ndërsa për rastet ku kanë përfunduar afatet ligjore ose nuk ekziston më arsyeshmëri ekonomike për inkasim, duhet të bëhet fshirja e tyre në mënyrë që të pastrohen llogaritë e arkëtueshme (LL/A).</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Ndërmarrja është pajtuar me gjetjen mirëpo ka dhënë arsye plotësuese lidhur me çështjen e prezantuar.</p>
<p>Mos barazimi i debisë dhe i kredisë në shënimet kontabël</p>	<p>Programi I Kontabilitetit e ka mangesi per mosbarazimin e urdheresave financiare te cilin nuk e kemi verejt me kohe dhe tani veq jemi te adresuar qeshtjen e kesaj mangesie dhe automatikisht rregullohet ky problem.</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Ndërmarrja është dakorduar me gjetjen, ndërkohë ka dhënë arsyetime lidhur me çështjen e trajtuar.</p>

<p>Ndërmarrja nuk e kishte prezantuar saktë periudhën krahasuese</p>	<p>Duke pas parasysh se shenimet ne PFV 2024 kan pas probleme me saktetin e te dhenave dhe sipas informimeve te menaxhmentit te larte keto pasqyra I kan derguar ne disa instucione per trajtim, dhe se draft raporti fillestar I auditorit iu ka ardhur me opinion te kundert, pastaj iu vjen me modifikim me gjetje dhe nuk kan qene te nenshkruara nga kryeshefi ekzekutiv gjat kontrollit te tyre kam hase ne gabimet ku Detyrimet tatimore jane nenvlersuar per 6023 euro qe jane te pasqyruara ne shpalosje. detyrimet ndaj furnitoreve kan qene te mbivlersuara per 454 tatimi ne fitim eshte prezentuar ndryshe ne ne PFV dhe ndryshe ka qene ne Deklaraten tatimore (CD) gjithashtu edhe fitimi pas tatimit ndryshe ne deklaraten tatimore e ndryshe ne ne PFV .</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Ndërmarrja është pajtuar me gjetjen mirëpo ka dhënë arsye plotësuese lidhur me çështjen e prezantuar. Megjithatë të gjitha korigjimet duhet të bëhen në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.</p>
--	---	--



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të NPL Stacionit të Autobusëve SH.A, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe përmbajtjen e Raportit përveç çështjeve, Çështja A1- Çështja C1- Çështja B1- Çështja A3- Çështja A4- Çështja A5- Çështja A6
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Pajtim DEMAJ
Kryesues i Bordit të Drejtues
NPL Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë
Data: 18 Prill 2020 Prishtinë



Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINE
GJ.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J. S.



	NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. GJ.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D. MPE "BUS STATION" J. S.	
Nr No	<u>08/455</u>	Data Date
		<u>19.03</u> 20 <u>26</u>
PRISHTINË/A		

N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A Prishtinë

Raport i Kontabilistit të certifikuar

Pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2025



Përmbajtja

Raporti i Kontabilistit të Certifikuar për përpilimin e Pasqyrave Financiare të Kompanisë NPL"Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.	3
Pasqyra e pozitës gjithëpërfshirëse financiare më 31 dhjetor 2025.....	4
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025.....	5
Pasqyra e e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025.....	6
Pasqyra e rrjedhës së parasë - Metoda indirekte	7
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE.....	8-30
Informata të përgjithshme	31



Raporti i Kontabilistit të Certifikuar për përpilimin e Pasqyrave Financiare të Kompanisë NPL "Stacioni i Autobusëve".Sh.A. Prishtinë

Fushëveprimi

Në bazë të informacionit të dhënë dhe në përputhje me angazhimin e shërbimit sipas marveshjes, ne kemi përpiluar pasqyrat financiare për NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë për vitin e mbyllur që përfundon me 31 dhjetor 2025. Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshkruara në Shënimet e këtyre pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë

Menaxhmenti i kompanisë është plotësisht përgjegjës për informacionin që përmbajnë pasqyrat financiare e përcaktuar nga standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVMM) të kërkuara nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar. Ne jemi angazhuar për të plotësuar kërkesat ligjore si dhe për të përmbushur nevojat për qëllimin që janë përgatitur këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare janë përgatitur ekskluzivisht për përfitimin e Kompanisë. Ne nuk pranojmë përgjegjësi ndaj asnjë personi tjetër për përmbajtjen e pasqyrave financiare.

Nuk janë kryer procedura Auditimi/ rishikimit.

Procedurat tona përdorin ekspertizën e kontabilitetit për të bërë përpilimin e pasqyrave financiare nga informacionet që na janë ofruar. Procedurat tona nuk përfshijnë procedurat e verifikimit ose vlefshmërisë. Asnjë angazhim auditim ose rishikimi nuk është kryer dhe në përputhje me rrethanat nuk është shprehur asnjë siguri.

Pavarësia

Ne nuk kemi asnjë përfshirje tjetër në kompaninë, përveç përgatitjes së pasqyrave financiare duke u bazuar në informacionin financiar të cilin kompania na e ka ofruar.

Heqja e përgjegjësisë

Ne kemi përpiluar këto pasqyra financiare bazuar në informacionin e dhënë i cili nuk ka qenë subjekt i një angazhimi të Auditimit ose rishikimit. Prandaj, ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi për besueshmërinë, saktësinë apo tërësinë e informacionit financiar të përpiluar të përfshirë në pasqyrat financiare. Nuk pranojmë asnjë përgjegjësi të çfarëdo lloji, përfshirë përgjegjësinë për shkak të pakujdesisë, ndaj cilitdo person për humbjet e bëra si rezultat i besimit në këto pasqyra financiare.

Emin Sylejmani

Kontabilist i certifikuar me nr.489



STACIONI I AUTOBUSEVE SH.A.

Adresa: PRISHTINË, Bill Clinton

NUI: 811318741; TVSH; 330088551

Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2025


	Shnm.	2025 €	2024 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	994,531	753,716
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	119,451	117,289
Stoqet	8	341	720
Pasuritë e tjera afatshkurtra	9	143,913	113,941
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		1,258,235	985,666
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	10	20,514,007	10,969,968
Gjithsej pasuritë afatgjata		20,514,007	10,969,968
Gjithsej pasuritë		21,772,243	11,955,634
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	11	32,799	36,245
Detyrimet e Tatimit ne fitim	12	25,088	-
Detyrimet tjera Afat Shkurta	18	48,865	37,915
Gjithsej detyrimet afatgjata		106,752	74,160
EKUITETI			
Kapitali aksionar		25,000	25,000
Fitimet e mbajtura		(2,172,383)	(2,340,191)
Rezervat e tjera		23,812,874	14,196,655
Gjithsej ekuiteti		21,665,491	11,881,464
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		21,772,243	11,955,624

Zyrtari Kryesor Financiar dhe I thesarit
Shpend Gjugja

Kontabilist i certifikuar 489
Emin Sylejmani



UD Kryeshefi
Ekzekutiv
Veton Prelvukaj





Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

	Shënimi	2025 €	2024 €
Të hyrat	13	1,745,582.88	1,527,153.97
Kostoja e shitjes	14	(262,043.83)	(306,505.18)
Fitimi / (humbja) bruto		1,483,539.05	1,220,648.79
Shpenzimet administrative- Pagat	15	(1,095,166.08)	(896,199.74)
Shpenzimet e tjera Operative	16	(104,317.71)	(98,013.26)
Shpenzimet e Zhvlersimit	14	(91,345.33)	(81,064.00)
Fitimi / (humbja) operativ	17	192,709.93	145,371.79
Shpenzimet e tatimit në fitim	12	(25,087.53)	
Fitimi / (humbja) i/e vitit		167,622.41	145,371.79



Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2024	25,000.00	(2,471,025.00)	14,196,655.00	11,750,630.00
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	130,834.00		130,834.00
Diferencat nga përkthimet valutore		-		-
Dividendat		-		-
Deponimet e kapitalit shtesë		-		-
Ndarja e rezervave				-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	25,000.00	(2,340,191.00)	14,196,655.00	11,881,464.00
Fitimi / (humbja) i/e vitit		167,622.41	-	167,622.41
Diferencat nga përkthimet valutore		-		-
Dividendat		-		-
Deponimet e kapitalit shtesë		-		-
Ndarja e rezervave				-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	25,000.00	(2,172,382.95)	14,196,655.00	12,049,086.41



Pasqyra e rrjedhjes së parasë v për vitin që përfundon më 31 dhjetor
2025

Shënimi	2,025	2,024
	€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi /(humbja)i / e vitit	167,622	125,018
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	91,520	81,064
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	-	186
	259,143	212,085
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative (Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(2,162)	(12,232)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	379	-
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	(29,972)	(17,988)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(3,446)	-
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	10,950	10,974
Detyrimet e Tatimit ne fitim	25,088	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	259,980	192,839
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(19,166)	(6,838)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(19,166)	(6,838)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	240,814	186,001
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	-	-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	240,814	186,001
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	240,814	186,001
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	240,814	186,001
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	753,716	567,706
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	994,531	753,707



NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A, Prishtinë Shenimet e Pasqyrae financiare më 31 dhjetor 2025

Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

1. Informata të përgjithshme

Ndërmarrja Shoqërore Stacioni i Autobusëve, është themeluar me vendimi te Kuvendit Komunal te Prishtinës me aktin nr. 110-94/77-01, te datës 15 Nëntor 1977. Ndërsa, kjo ndërmarrje punën e ka filluar ne vitin 1983.

Pas përfundimit te luftës se vitit 1999, kjo ndërmarrje është regjistruar ne baze te rregullores se UNMIK-ut 2000/6 mbi Shoqëritë Tregtare me numër te biznesit 80060165 datë. 14.06.2000 dhe është administruar nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) dhe më pastaj i transformuar Agjencioni Kosovari i Privatizimit (AKP).

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr. 04/L – 111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, Stacioni i autobusëve SH.A. në Prishtinë është paraparë në Listën 2, ku janë caktuar Ndërmarrjet publike lokale në nivel të Kosovës. Mbi bazën e këtyre ligjeve, Kuvendi Komunal i Prishtinës është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i te gjitha aksioneve te ndërmarrjes.

Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, Stacioni i autobusëve, veprimtarinë e tij do ta ushtrojë me emërtimin: Ndërmarrja publike lokale "Stacioni i autobusëve", SH.A, Prishtinë i regjistruar me numër te ri te biznesit (NRB) 71224851 me datë 21.01.2015 dhe me numër fiskal pranë ATK-se 600118245. Emërtimin i shkurtër i ndërmarrjes së cekur në paragrafin 2 të këtij neni është: NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Prishtinë.

Kuvendi Komunal i Prishtinës ne emër te pronarit te vetëm te aksioneve e ushtron kompetencën dhe përgjegjësinë në bazë te Ligjit, Statutit dhe akteve tjera nënligjore.

Ndërmarrja është e licencuar nga Ministria e transportit dhe Postë Telekomunikacionit për ushtrimin e veprimtarisë së sajë me Licencë me nr.002/18 të datës 02.05.2018. Licenca lëshohet për 5 (pesë) vite e cila ka karakterin e plasimit në kategorizimin e stacioneve e cila sipas licencës në fjale i ka plotësuar kushtet për kategorinë "A" nga katër kategoritë e parapara me Udhëzimin Administrativ (kat. "A", "B", "C" dhe "D" nga ma kualitative në atë më të dobët).Ndërmarrja posedon sipërfaqe e objekte të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarisë si vijon :

- Sipërfaqe 7 ha e 62 ari e 29m², (Fleta Poseduese ZK Prishtinë nr. 8296 me numërprotokolli 2262/02 dt. 10.07.2002.
- Ndërtesa e drejtorisë afërsisht 5228 m²,
- Servisi i larjes së autobusëve me dy kanale afër 568 m² katrore.
- Perona 21 me nr.rendor prej 1 deri 21 me mbishkrim të linjës. Ndërmarrja posedon edhe objekte përcjellëse si që janë: informata, dispiqeringu, biletarinë, shenjat e komunikacionit vertikal dhe horizontal, stazat dhe parkingu.

Aktivitetet e ndërmarrjes janë:

- a) Pranimi dhe përcjellja e autobusëve,
- b) Pranimi dhe përcjellja e udhëtarëve,
- c) Shitja dhe rezervimi i biletave të autobusëve për kompanit e transportit të udhëtarëve, kryesisht të sektorit privat, për linjat urbane, urbane periferike, ndërrurbane dhe ndërkombëtare,
- d) Informimi i udhëtarëve,
- e) Dhënia e shërbimeve turistike,
- f) Pranimi dhe ruajtja e bagazhit,
- g) Kontrolli i respektimit të rendit të udhëtimit,
- h) Shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorët transportues,

- i) Shfrytëzimi i hapësirave të Stacionit (qiradhënie),
- j) Ndërmarrja mund të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të paraparë nga legjislacioni në fuqi.

Ndërmarrja ka llogarinë e vet bankare ne NLB Prishtina dhe në BKT(Banka Kombtare Tregtare. Transaksionet e firmës kryhen përmes llogarisë bankare ne NLB Prishtina.

Ndërmarrja sipas Ligjit dhe Statutit ka Bordin drejtuese të zgjedhur nga komuna e Prishtinës, (aksionari), Kryeshefin Ekzekutiv të zgjedhur nga B.D , Sekretarin të zgjedhur nga B.D ,ZKFTH të zgjedhur nga B.D , Auditorin e brendshëm të zgjedhur nga B.D dhe punëtorët që janë të dizajnuar në shemën organizative dhe me datë 31.12.2025 ka pasë te punësuar gjithsej 104 punëtorë, duke përfshirë ne listën e pagave edhe katër anëtar te bordit te drejtoreve dhe 2 anëtarë aksionar. Në vitin 2025 janë pensionuar gjithsej 2 punetor ku i kanë marre te gjithë nga 3 paga përcjellëse . Në vitin 2025 është pranuar një punëtorë (Auditori i Brendshëm) sipas konkursit te hapur ne Prill 2025 dhe e fillon punën me Maj 2025.

2. Bazat e përgatitjes dhe Politikat e kontabilitetit

2.1 Përputhshmëria dhe baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Interpretimet (ndryshe IFRS) të botuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) siç janë adaptuar nga Unioni Evropian ("IFRS të adaptuara"), UDHËZIM ADMINISTRATIV MF-NR. 07/2019 PËR STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN DHE DORËZIMIN E RAPORTIMEVE FINANCIARE VJETORE . Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat matëse te specifikuara ne procedura për çdo lloj të aseteve, të detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë plotësisht të përshkruara në politikat e kontabilitetit më poshtë

2.2 Parimi i vazhdimsisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdimsisë.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdimi)

2.3 Standardet, interpretimet dhe amendamentet e reja që hyn në fuqi nga 01 Janar 2019. (VAZHDIMI)

- SNFR 15 - Objektivi i këtij Standardi është përcaktimi i parimeve që duhet të zbatohet një njësi ekonomike për të raportuar tek përdoruesit e pasqyrave financiare informacion të dobishëm mbi natyrën, madhësinë, kohën dhe pasigurinë e të ardhurave dhe flukseve të mjeteve monetare që vijnë nga një kontratë me një klient.
- UDHËZIM ADMINISTRATIV MF-NR. 07/2019 PËR STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN DHE DORËZIMIN E RAPORTIMEVE FINANCIARE VJETORE
- LIGJI NR. 06/L- 032 PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM
- **Neni 6**

Përgatitja e dokumenteve të kontabilitetit

- 1. Dokumenti i kontabilitetit duhet të jetë autentik, në gjendje të rregullt dhe i përgatitur në atë mënyrë që siguron mbikëqyrje me kohë. Personi i autorizuar për përfaqësim të ndërmarrësit ose personit të autorizuar për përfaqësim me delegim të autoritetit garanton me nënshkrim të tij në dokumentin e kontabilitetit se ky i fundit është autentik dhe në gjendje të rregullt.
- **Neni 7**
- Zbatimi i standardeve për përgatitjen e pasqyrave financiare për shoqëritë tregtare të mëdha.



2.4 SNK 1, SNK 8 Definicioni i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)

Ndryshimet janë efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2020. Lejohet adaptimi i mëhershëm. Amandamentet sqarojnë përkufizimin e materialit dhe harmonizojnë përkufizimin e përdorur në Kornizën Konceptuale dhe standardet.

Adaptimi i këtyre ndryshimeve dhe standardeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë.

Kompania ka filluar t'i zbatojë këto standarde pas miratimit të tyre.

2.5. Ndryshimet në Referencat në Kornizën Konceptuale në Standardet e SNFR-ve

Së bashku me kornizën Konceptuale të rishikuar të publikuar në mars 2018 , BSNK gjithashtu ka nxjerrë ndryshime në Referencat në Kornizën Konceptuale në Standardet e SNFR-ve. Dokumenti përmban ndryshime në SNFR 2 , SNFR 3, SNFR 6, SNFR 14, SNK 1, SNK 8, SNK 34, SNK 38, KIRFN 12, KIFRN 19, KIFNR 20 , KINFR 22 dhe KIS-32.

2.6 Valuta e prezantimit

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euro (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euro ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR). Pasqyrat financiare janë përgatitur nën marrëveshjen e kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuara sikurse janë të përshkruara tutje në këto shënime.

